

**Nr. 2501/001 K (e-k) Prot.**  
**Tiranë, më datë 06/01/2025**

**Drejtuar:** Komisionit Qendror të Zgjedhjeve  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Komisionit Rregullator

**Lënda:** REKOMANDIME – Lidhur me Projektvendimin “Për caktimin e detyrave dhe përgjegjësive të auditëve teknikienë për verifikimin e veprimeve të realizuara nga KQZ-ja për regjistrimin e shtetasve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet në Kuvend, të datës 11 maj 2025.”

**I nderuar z. Komisioner!**  
**Të nderuar Anëtarë të Komisionit Rregullator!**  
**Të nderuar Drejtues të Administratës së KQZ-së!**

Në kuadër të bashkëpunimit me ju lidhur me konsultimin paraprak të projekt-akteve, për të cilin gjejmë rastin t’ju falënderojmë sërish, lidhur me projektvendimin “Për caktimin e detyrave dhe përgjegjësive të auditëve teknikienë për verifikimin e veprimeve të realizuara nga KQZ-ja për regjistrimin e shtetasve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet në Kuvend, të datës 11 maj 2025”

**KRIIK ju paraqet, më poshtë qëndrimin dhe rekomandimet e veta lidhur me këtë Projektvendim.**

Më së pari, duke qenë se tanimë afatet ligjore të vendosura nga Kodi Zgjedhor për emërimin e auditëve teknikienë janë tejkaluar, KRIIK **nxit Komisionerin dhe Nënkomisioneren për emërimin sa më të shpejtë të tyre.**

Lidhur me përmbajtjen e projektvendimit:

1. Në vlerësimin e KRIIK, detyrat e auditëve teknikienë të listuara në projekt-vendim janë të detajuara dhe, në dukje, të plota. Megjithatë, gjykojmë se është e nevojshme që në hyrje të aktit të vendoset një pikë që përcakton se në parim, audituesit teknikienë janë përgjegjës për të verifikuar në tërësi integritetin dhe sigurinë e procedurave të implementuara nga KQZ-ja për regjistrimin e shtetasve që votojnë nga jashtë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator. Në gjykimin e KRIIK, auditimi është një mekanizëm i brendshëm i KQZ-së për të garantuar dhe siguruar integritetin e plotë të procesit në

**Address:**

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

**Mailingaddress:**

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

mënyrë të tillë që, në çdo rast kontestimi apo pikëpyetjeje të ngritur, barra e provës t'i përkasë KQZ-së.

Pra nevojitet një pikë e përgjithshme që përfshin gjithë elementët sa më poshtë vijojnë në projektvendim, por që lejon edhe mundësinë për elementë të cilët mund të jenë të pambuluar në mënyrë eksplicite në to. Renditja vetëm e detyrave të audituesve, sikurse është në projektvendim, pa këtë pikë përgjithësuese mund të kufizojë përgjegjësitë dhe kompetencat e pakufizuara që duhet të kenë auditët teknikienë

2. KRIIK gjykon se titulli i pikës 1 “Auditi i Kuadrit Ligjor dhe Rregullator” dhe pika e dytë e po kësaj pike (“Të shqyrtojë procedurat e miratuara për regjistrimin e votuesve nga jashtë”) janë të shprehura në mënyrë jo totalisht korrekte dhe në pamje të parë krijojnë keqkuptimin se auditët do të auditojnë kuadrin ligjor dhe rregullator (një detyrë që nuk ka kuptim dhe nuk qëndron). Gjuha e përdorur do të duhet të përcaktojë në mënyrë eksplicite se auditët shqyrtojnë **përputhshmërinë e hapave të ndjekur nga KQZ-ja për implementimin konkret të kuadrit ligjor dhe rregullator** dhe jo vetë kuadrin ligjor dhe rregullator.

3. Në pikën nr. 10, Raportimi dhe Rekomandimet, vërehet se **roli i auditëve nuk është vetëm konstatues, por edhe vlerësues e propozues në funksion të përmirësimit**. Në këtë funksion, KRIIK vlerëson se **është i nevojshëm përcaktimi i saktë i mënyrës dhe kohës së raportimit, si dhe i procedurës për shqyrtimin e raporteve dhe implementimin e rekomandimeve të auditëve teknikienë**.

Në lidhje me sa më sipër, duke marrë në konsideratë implementimin për herë të parë, si dhe faktin që auditët mund të kryejnë rekomandime konkrete për përmirësim, është i nevojshëm një raportim më i shpeshtë se një herë në muaj, sikurse normalisht auditët teknikienë kryejnë (p.sh. çdo dy javë), si dhe të përcaktohet qartë që raportimi lidhur me këtë pjesë të Kodit Zgjedhor, të jetë i ndarë nga auditimi i pjesës tjetër të listës së zgjedhësve.

Gjithashtu, është e nevojshme që të përcaktohet qartë procedura e shqyrtimit të raporteve të tyre nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe hapat që do të ndërmerren për adresimin e rekomandimeve nga auditët teknikienë.

KRIIK propozon që të përcaktohet në vendim se raportet e auditëve duhet të prezantohen, shqyrtohen dhe miratohen gjithmonë në seancë publike, që raportet do të publikohen në faqen e internetit të KQZ-së, dhe gjithashtu të specifikohen mekanizmat se si konkretisht gjetjet dhe rekomandimet e tyre do të adresohen në rast se evidentohen problematika.

Gjithashtu, **duke konsideruar rolin dhe rëndësinë në proces të auditëve teknikienë, KRIIK e gjen me vend i nderuar Z. Komisioner, të ri sjellë në vëmendjen tuaj disa elementë, të rekomanduar më parë nga KRIIK, dhe që kanë nevojë për reflektim në funksion të përmirësimit të këtij mekanizmi.**

#### **Konkretisht:**

Duke vërejtur se emërimi i auditëve si dhe kushtet e punës së tyre bazohen në Kodin Zgjedhor, neni 61, si dhe në Udhëzimin e KQZ nr. 2 datë 28.12.2012, ndërkohë që ndryshimet e fundit në nenin 61 të Kodit Zgjedhor janë bërë në vitin 2020 me ligjin 101/2020; **KRIIK gjykon se edhe Udhëzimi nr. 2, datë 28.12.2012 duhet përditësuar, duke qenë se disa prej neneve që përbëjnë bazën ligjore kanë ndryshuar.**

#### Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

#### Mailingaddress:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

Sipas ligjit KQZ është institucioni që mbikëqyr procesin e hartimit të listave të zgjedhësve (neni 61, pika 1 e Kodit Zgjedhor “KQZ-ja mbikëqyr procesin e hartimit të listave, duke i kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe njësisive të qeverisjes vendore për...”). Për realizimin e plotë të këtij detyrimi, disa elemente të vërejtura në vazhdimësi të proceseve zgjedhore, duhet të jenë pjesë e udhëzimit por edhe e urdhrave të Komisionerit në funksion të zbatimit të ligjit.

Specifikisht:

1. Auditët teknicienë duhet të paraqesin raport auditimi çdo muaj në KQZ, Kodi Zgjedhor Neni 61 pika 7 “Auditët teknicienë i paraqesin një raport auditimi çdo muaj KQZ-së për gjetjet e auditimit, sipas detyrave të përcaktuara nga KQZ-ja ose për vërejtje apo çështje që lidhen me zbatimin e legjislacionit në lidhje me regjistrin e gjendjes civile”.

2. Gjetjet e raporteve, së bashku me kërkesën për sqarime i dërgohen për shpjegime DPGJC. Neni 61 pika 8 “KQZ-ja ia përcjell gjetjet dhe rekomandimet e auditëve teknicienë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile brenda 48 orëve, duke i kërkuar njëkohësisht shpjegime për to”.

3. Raportet e auditëve duhet të prezantohen, shqyrtohen dhe miratohen gjithmonë në seanca publike. Në vijimësi të proceseve zgjedhore, pavarësisht se auditët kanë ngritur problematika shpesh të konsideruara tepër serioze, KQZ-ja është mjaftuar me përmbushjen e detyrimit ligjor të përcjelljes së raporteve në DPGJC dhe publikimin e tyre në faqen e internetit. Në zbatim të ligjit, përpos etapave të mësipërme, KQZ duhet t'i kushtojë vëmendje nëpërmjet mekanizmave të brendshëm gjithë procesit pas përcjelljes së raporteve të auditëve në DPGJC, duke:

- Publikuar të gjitha shpjegimet në faqen zyrtare të internetit, sipas Kodit Zgjedhor (Neni 61 pika 8 “Raportet e auditëve dhe shpjegimet e DPGJC-së bëhen publike nga KQZ-ja”).
- Kryer shqyrtimin e shpjegimeve të DPGJC në seancë publike, sipas rastit edhe me prezencë të DPGJC dhe auditëve.
- Përcaktuar afate lidhur me gjithë procesin sa më sipër, Zbatimi i sa më sipër bazohet në gjykimin se, sipas germës dhe frymës së ligjit, qëllimi i mbikëqyrjes nga KQZ të procesit të hartimit të listës së zgjedhësve konsiston në qëndrimin aktiv ndaj problematikave të vërejtura prej auditëve, duke ndërmarrë hapa konkretë në ndjekjen e deri në zgjidhjen e tyre.

**Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,**

**Me konsideratë,**

***Për* Koalicionin Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

**Premto GOGO**

**Kryetar**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania